



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1501 / prot

Koplik më: 15 / 06 / 2026

PROJEKT -VENDIM
Nr _____, Datë 15 / 06 / 2026

**PËR
MIRATIMIN E PËRDORUESIT FAKTIKE TË TOKËS BUJQËSORE PER
NJESINË KOPLIK**

Bazuar ne shkresën nr.4725 datë 22.05.2026 të Drejtorisë Vendore ASHK Shkodër si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” pika 3 neni 14 dhe të VKM –së 1182 /2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore” pika 10.

VENDOSI:


Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe :

I- Të miratojë përdoruesin faktik të tokës bujqësore, z.Paulin Ejll Smakaj ne Koplik, Njësia Koplik, Bashkia Malësi e Madhe, Zona Kadastrale 2220 sipas dokumentacionin përkatës të sjellë nga Drejtoria Vendore Ashk Shkodër.

II- Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Vendore Ashk Shkodër.

Bashkangjitur gjeni dokumentacionin e paraqitur nga ASHK Drejtoria Vendore Shkoder.

Faleminderit për mirëkuptimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE SHKODER

Nr. 4727 prot

22.05.2026
Shkodër më 24.05.2026

Lenda: Përcjellje e dokumentacionit "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore", në zbatim të pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020.

Drejtuar:

Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ✓

Adresa : KOPLIK

Nga ana e Taks-Forces të ngritur me VKM-ne nr.320/2023 në bashkëpunim me përfaqësuesit e Drejtorise Vendore ASHK Shkoder, po kryhet procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në zbatim të Kreut 2, Seksionit 3, të Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", si dhe VKM-së nr.1182/2020 "Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", konkretisht për Koplikun, zk.2220, Njësia Administrative **Koplik**, Bashkia Malësi e Madhe.

Me shkresën nr.2450/1 datë 02.04.2026 është përcjellë pranë Bashkisë Malësi e Madhe për afishim e përdoruesi dhe paraqitja grafike e sipërfaqes së kërkuar :

1. PAULIN EJLL SMAKAJ

Me shkresën nr.270/58 datë 11.05.2026 ka konfirmuar që ka përfunduar afishimi (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.2450/2 prot hyrës, datë 14.05.2026). **dhe konfirmon se nuk ka pasur asnjë ankimim.**

Në vijimësi të procedurës "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore" sipas pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020, po ju përcjellim për miratim relacionin së bashku me dokumentacionin përkatës (liste e përdoruesve faktike, planvendosje të pasurive) , për subjektin e mësipërm.

Faleminderit!

DREJTOR

EGLANTINA FRROKU

Eglantin

Digitally signed by
Eglantina Frroku
Date: 2026.05.22
12:26:25 +0200



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkoder
Date: 2026/05/22 13:31:46 +02'00'
32taSHKODER2026052219313926014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)

PLANVENDOSJE E NGASTRËS PËR KALIMIN NË PRONËSI PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE PËR PËRDORUESIT

DVASHK SHKODER BASHKIA MALESI E MADHE

SEKTORI: AMTP

SEKTORI:

SPECIALIST: Erjeta Ramaj

SPECIALIST:

PERGJEGJES: Suad Smakaj

PERGJEGJES:

DATA: 17/02/2026

DATA: _/_/_

NR.KËRKESËS: 86 DATË: 23.10.2020

ZONA KADASTRALE: 2220

NUMRI PASURISË: 963/1

INDEKSI I HARTES: K-34-63-(95-C)


SHKALLA: 1 : 2500

SIPËRFAQJA E NGASTRËS BUJQËSORE : 16152 m2

ZERI KADASTRAL ARE

SUBJEKTI: PAULIN EJLL SMAKAJ
emër atësi mbledhës

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



KUFITARËT SIPAS DEKLARIMEVE TE POSEDUESIT:

VERI: Pëllumb Zajzo, Lindita Delisha, Jonuz Delisha

JUG: Rruga

LINDJE: Hilmi Curri (ose Curra)

PERENDIM: Antonio Smakaj

LEGJENDA: [Symbol] SIPËRFAQJA E NGASTRËS PER KALIM PRONESIE

Eglantim

Sipërfaqja e ngastres për kalim pronësie
Eglantim në hartë
Data: 17/02/2026

MIRATIM

DREJTORI

Eglantim

emër

mbledhës

nënshkrimi

vula

shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe kthyer me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)

MIRATOI

PERFAQËSUESI AUTORIZUAR I NJVV

emër

mbledhës

nënshkrimi

vula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA SHKODER
RELACION

SHKODËR
DREJTORIA VENDORE

MBI TRAJTIMIN E KËRKESËS NR. 86 PROT. DT. 23.10.2020 PËR KALIMIN PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE NGA PËRDORIMI NË PRONËSI PËR SUBJEKTIN PAULIN EJLL SMAKAJ.

Subjekti PAULIN EJLL SMAKAJ, me kërkesën nr. 86 datë. 23.10.2020, ka paraqitur pranë Bashkisë Malësi e Madhe, kërkesën për kalimin në pronësi të tokës bujqësore që ai posedon në Koplik, Njësia Administrative Koplik, me sipërfaqe **16152 m²**, nga përdorimi në pronësi dhe konkretisht parcela:

1-Ngastra 963/1 me sipërfaqe 16152 m².

Parashtrimi i fakteve:

Situata ligjore

-Kërkesa e subjektit nr.86 prot. dt. 23.10.2020 është paraqitur pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore Koplik, brenda afatit ligjor 6 (gjashtë) muor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 20/2020 "Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Referuar korrespondencës së mbajtur me DAMT, konkretisht me shkresën nr. 503/1 prot dt. 10.11.2025 si dhe shkresës 137/2, datë 04.03.2026 (administruar pranë ASHK Shkodër me nr.2450 prot.hyrës, datë 17.03.2026) konfirmohet se Kopliku është pjesë e ish-kooperativës bujqësore Koplik.

-VKM nr. 1182/2020 pika 4.1, subjekti kerkues rezulton me gjendje familjare dt. 01.08.1991 në Koplik dhe me certifikaten familjare te familjes bujqesore dt. 03.11.2025 në Koplik.

-Pika 4/1/b e vkm 1182/2020 ka përcaktuar se subjekti, që ka paraqitur kërkesë për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, nuk duhet të ketë përfituar tokë bujqësore në territorin e ndonjë ish-kooperative apo ish-ndërmarrjeje bujqësore tjetër. Për vlerësimin e këtij kushti, ASHK-ja shqyrton dokumentacionin e administruar nga struktura e kadastrës së rrethit, referuar vendbanimit në datën 1.8.1991 dhe vendbanimit aktual, në raport me vendndodhjen e pronave për të cilat subjekti kërkon të pajiset me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë ngastra:

-Pika 4/2/a përcakton se "T'i përkasë një prej llojeve të tokës bujqësore (arë, pemëtoje, vresht dhe ullishte), në momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore. Për verifikimin e llojit të pasurisë, ASHK-ja i referohet dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Administrimit të Tokës, si: librat e tokës, librat e ngastrave të fshatit, regjistrat apo dokumentacioni ku janë pasqyruar të dhëna dhe tregues për tokën bujqësore apo për kategorinë e resursit të tokës, gjatë periudhës 29 gusht 1945 deri në 19 shtator 1991, hartat kadastrale të afërta me momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi, si edhe aktet e organeve publike, nëpërmjet të cilave janë realizuar ndryshime apo kalime të tokës bujqësore në resurse të tjera dhe anasjelltas.

Nga verifikimi i parcelave të sipër cituara për kalim pronësie rezulton brenda konfiguracionit të hartës së DAMT me zërin kadastral arë, kusht për llojin e tokës sipas VKM 1182 /2020 pika 4.2:



- Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk rezulton të jetë në pronësi të të tretëve. Për këtë qëllim janë verifikuar regjistrimet. Nga baza e të dhënave rezulton se pasuria është shtet në volum 14, faqe 76, te ZK. 2220.

-Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i formave të kompensimit fizik sipas ligjit nr. 133/2015” Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”. Referuar korrespondencës së mbajtur me ATP-në shkresa nr.prot. 5579/1 dt. 05.11.2025 administruar pranë ASHK Shkodër me prot. 5890/3 dt. 11.11.2025 konfirmohet që toka nuk është objekt i formave të kompensimit fizik sipas ligjit nr. 133/2015.

-Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i investimeve strategjike,sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë. AIDA me shkresën nr.1528/1 prot. dt. 08.08.2025 administruar pranë zyrës me nr. 5889/1 prot. Dt. 12.08.2025 ka konfirmuar toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i investimeve strategjike.

Dokumentacioni i administruar:

- Nga ana e subjektit Paulin Ejll Smakaj janë depozituar: kërkesa nr.86 dt. 23.10.2020, certifikatë familjare 23.10.2020 ku pasqyrohet përbërja familjare dt.01.08.1991.
- Nga DAMT-ja është përcjellur dokumentacioni me shkresën nr. nr. 503/1 prot dt. 10.11.2025 si dhe shkresës 137/2, datë 04.03.2026 (administruar pranë ASHK Shkodër me nr.2450 prot.hyrës,datë 17.03.2026).
- Nga Njësia Administrative Koplik ,Bashkia Malësi e Madhe, Zyra e Gjendjes Civile Koplik sipas shkresës nr. 750/1 prot, 05.11.2025 (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.8935/1 prot, datë 10.11.2025) është përcjellur përbërja familjare aktuale, ku konfirmohet banor aktual i Koplikut sipas certifikatës familjare dt.03.11.2025.

Nga Bashkia Malësi e Madhe janë administruar shkresat:

- Shkresa 70/58, datë 11.05.2026 administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.2450/2 prot hyrës, datë 14.05.2026 ku konfirmohet afishimi publik 30-ditor dhe që nuk ka pasur ankesa gjatë kësaj periudhe.
- Shkresa 70/32, datë 12.03.2026 administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.1935/1 prot hyrës, datë 17.03.2026 ku janë firmosur dhe konfirmuar planvendosjet e dërguara nga ana e ASHK.

Situata faktike:

U krye verifikimi në terren në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe. Gjatë këtij procesi mori pjesë përfaqesuesi i Njesisë Vendore të Vetëqeverisjes i vënë në dispozicion nga Bashkia Malesi e Madhe z. Elsad Curri.

Nga verifikimi në terren sipas akt konstatimit prot.1 dt. 12.01.2026 nga grupi i terrenit, u konstatua se subjekti posedon një parcelë me sipërfaqe **16152** m2 në Koplik, pjesë e kooperativës bujqësore Koplik .

Kjo sipërfaqe përfshihet në **Z.K. 2220**, të Njësise Administrative Koplik, Malësi e Madhe, konkretisht ngastra me numër pasurie **963/1**, vol. 14, faqe 76, me zërin kadastral arë sipas rregjistrimit dhe dokumentacionit DAMT, kusht për llojin e tokës sipas VKM 1182 /2020.

Administruar në dosje deklarata noteriale e kufitarëve me nr. 1538 Rep, nr.861 Kol, datë 21.03.2026 tek

notere Eureka Mujaj.

Me shkresën nr.2450/1 datë 02.04.2026 është përcjellë pranë Bashkisë Malësi e Madhe për afishim e përdoruesi dhe paraqitja grafike e sipërfaqes së kërkuar.

Me shkresën nr.270/58 date 11.05.2026 ka konfirmuar që ka përfunduar afishimi dhe nuk ka pasur ankesa (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.2450/2 prot hyrës, datë 14.05.2026).

**DREJTORI
EGLANTINA FRROKU**

Eglantin

Digitally signed by
Eglantina Frroku
Date: 2026.05.22
12:26:25 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2026/05/22 13:32:18 +02'00'
32GoSHKODER2026052213321186014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)